

# **NJOFTIME FITUESI PËR PROCEDURA TË KUFIZUARA**

## **DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT** FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

BASHKIMIN E OPERATORËVE EKONOMIKË: “ANTE-GROUP”.SH.P.K + “NOVA CONSTRUCTION 2012”,SH.P.K, ME NIPT J62904100D + L22404012D, ME ADRESË: NJËSIA BASHKIAKE NR. 10, RRUGA “KAJO KARAFILI”, MBRAPA ISH-LIDHJES SË SHKRIMTARËVE, PALLATI I SHOQËRISË MC INERTE, TIRANË.

OPERATORI EKONOMIK: “GJIKURIA”,SH.P.K, ME NIPT J62903456H, ME ADRESË: NJËSIA BASHKIAKE NR. 5, RRUGA “IBRAHIM RRUGOVA”, PRANË GARDËS SË REPUBLIKËS, PALLATI KONTAKT, MBI UNION BANK.

\* \* \*

Procedura e prokurimit:“Procedurë e Kufizuar, nëpërmjet marrëveshjes kuadër”, me disa operatorë ekonomikë ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara, në kuadër të procesit të rindërtimit.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF - 92604-04-08-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Rikonstruksion i objekteve të ish-Repartit “RENEA”, Drejtoria e Forcës së Posaçme Operacionale”,Linzë.

Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër do të jetë 12 (dymbëdhjetë) muaj. Kohëzgjatja e kontratës/kontratave do të jetë deri në 12(dymbëdhjetë) muaj nga momenti i lidhjes së minikontratës.

Publikime të mëparshme: S`ka

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 55 datë 12.04.2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

X oferta ekonomikisht më e favorshme

çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë: “2T”,sh.p.k + “BE-IS”, sh.p.k + “ERGI”,sh.p.k, me NIPT: K01731001M + K71412003A + K02727229P
2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë: “Ante-Group”.sh.p.k + “NOVA Construction 2012”,sh.p.k me NIPT: J62904100D + L22404012D
3. Operatori ekonomik: “ELDA-VL”,sh.p.k me NIPT K67106202W
4. Operatori ekonomik: “GJIKURIA”,sh.p.k me NIPT J62903456H

5. Operatori ekonomik: “SENKA”,sh.p.k me NIPT J94808405Q

Shënim: Në këtë fazë të procedurës nuk ju është kërkuar Operatorëve Ekonomikë, të paraqesin ofertë ekonomike.

Janë s’kualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë: “2T”,sh.p.k + “BE-IS”, sh.p.k + “ERGI”,sh.p.k, me NIPT: K01731001M + K71412003A + K02727229P
2. Operatori ekonomik: “ELDA-VL”,sh.p.k me NIPT K67106202W
3. Operatori ekonomik: “SENKA”,sh.p.k me NIPT J94808405Q

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë: “2T”,sh.p.k + “BE-IS”, sh.p.k + “ERGI”,sh.p.k, për arsyet si më poshtë:

Në nenin 77 pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se: *“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenti 66 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

a) Komisioni i vlerësimit të ofertave referuar dokumentationit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë: “2T”,sh.p.k + “BE-IS”, sh.p.k + “ERGI”,sh.p.k, në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në DST, Autoriteti Kontraktor, në pikën 2.2 *Kapaciteti ekonomik dhe financiar*, ka kërkuar: *“Kopje të çertifikuara të bilanceve për tre vitet e fundit kur ky informacion është i mundur”*, kriteri i cili nuk përmbushet nga BOE, pasi bilanci e dorëzuara nga operatori ekonomik “ERGI”,sh.p.k, pjesë e BOE nuk janë të çertifikuara/konfirmuara nga organet Tatimore.

b) Autoriteti kontraktor, në pikën 2.3 Kapaciteti teknik, pika “4”, ka kërkuar: *Stafi teknik i shoqërisë të ketë në përbërje, ndër të tjera: Inxhinier Elektronik, min. 1(një), i cili duhet të jetë i pasqyruar në Liçencës e Shoqërisë dhe Listëpagesa.*

Komisioni i vlerësimit të ofertave referuar dokumentationit të paraqitur nga operatori ekonomik “2T”,sh.p.k, pjesë e BOE, në përmbushje të kërkesës së mësipërme, i cili ka paraqitur dokumentacion e nevojshëm për Inxhinierin elektronik Z. Algenti Lala, por ky i fundit nuk është i pasqyruar në liçencës e shoqërisë siç parashikohet në DST. Pra kriter i cili nuk përmbushet nga BOE.

c) Autoriteti kontraktor, në pikën 2.3 Kapaciteti teknik, pika “11”, ka kërkuar: *Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë QKL III.2.B, Grumbullim dhe transportim i ujrave të ndotura urbane, llumbra septike dhe ujrave të zeza.* Komisioni i vlerësimit të ofertave referuar dokumentationit të paraqitur nga bashkimi i operatoriëve ekonomikë: “2T”,sh.p.k + “BE-IS”, sh.p.k + “ERGI”,sh.p.k, ka konstatuar se nuk është paraqitur dokumentacion për përmbushjen e kriterit të mësipërm. Pra kriter i cili nuk përmbushet nga BOE.

d) Autoriteti kontraktor, në pikën 2.3 Kapaciteti teknik, pika “17”, ka kërkuar: *Për drejtuesit e makinerive të rënda, siaps Urdhrit Nr. 44 datë 04.02.2004 “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe kriteret e dhënies e lejeve të manovrimit përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit””, dëshmi të aftësisë profesionale ose leje manovrimi të vlefshme të lëshuara nga MTI të vlefshme, min. 3 manovrator dhe min. 10 shofera të shoqëruar me kontratat e punëd dhe të figurojnë në listëpagesa.* Komisioni i vlerësimit të ofertave referuar dokumentationit të paraqitur nga bashkimi i operatoriëve ekonomikë: “2T”,sh.p.k + “BE-IS”, sh.p.k + “ERGI”,sh.p.k, nuk kanë paraqitur dokumentacion për plotësimin e punonjësve, min. 3 manovrator dhe min. 10 shofera. Pra kriter i cili nuk përmbushet nga BOE.

e) Autoriteti kontraktor, në pikën 2.3 Kapaciteti teknik, pika “18”, ka kërkuar: *Ofertuesi duhet të disponojë këto makineri, ndër të tjera: depozitë uji (40.000 Litra).*

Komisioni i vlerësimit të ofertave referuar dokumentationit të paraqitur nga bashkimi i operatoriëve ekonomikë: “2T”,sh.p.k + “BE-IS”, sh.p.k + “ERGI”,sh.p.k, nuk kanë paraqitur dokumentacion për plotësimin e këtij kriteri, pasi autoboti i paraqitur nga ana juaj rezulton të jetë për transportimin e lëndëve të rrezikshme duke u bazuar në lejen e transportit, fotove dhe faktin që kontrata respektive është pa emër objekti. Pra kriter i cili nuk përmbushet nga BOE.

f) Autoriteti kontraktor, në pikën 2.3 Kapaciteti teknik, pika “18”, ka kërkuar: *Ofertuesi duhet të disponojë këto makineri, ndër të tjera: Autobot uji për largimin e ujrave të zeza.*

Komisioni i vlerësimit të ofertave referuar dokumentationit të paraqitur nga operatori ekonomik “2T”,sh.p.k, pjesë e BOE, për autobotin për largimin e ujrave të zeza, autobot me Targa AA473RA, nga fotot e paraqitura vihet re se nuk e ka të inkuorporuar impiantin që kryen largimin e ujrave të zeza. Pra kriter i cili nuk përmbushet nga BOE.

g) Autoriteti kontraktor, në pikën 2.3 Kapaciteti teknik, pika “19”, ka kërkuar: *Operatori ekonomik duhet të paraqesë Analizë Çmimesh për të gjithë zërat e parashikuar në preventive.*

Komisioni i vlerësimit të ofertave referuar dokumentationit të paraqitur nga bashkimi i operatoriëve ekonomikë: “2T”,sh.p.k + “BE-IS”, sh.p.k + “ERGI”,sh.p.k, nuk kanë paraqitur dokumentacion për plotësimin e këtij kriteri. Pra kriter i cili nuk përmbushet nga BOE.

2. Operatori ekonomik: “ELDA-VL”,sh.p.k me, për arsytet si më poshtë:

Në nenin 77 pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se: *“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin*

*kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenti 66 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

a) Komisioni i vlerësimit të ofertave referuar dokumentationit të paraqitur nga operatori ekonomik “ELDA-VL”,sh.p.k, konstaton se ky i fundit nuk plotëson kriteret e kërkuara në dokumentat e tenderit, por ka paraqitur vetëm ekstraktin e regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”, datë 03.07.2018.

3. bashkimit të operatorëve ekonomikë: “SENKA”,sh.p.k + “GPG COMPANY”,sh.p.k, për arsyet si më poshtë:

Në nenin 77 pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se: *“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenti 66 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do

të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

a) Komisioni i vlerësimit të ofertave referuar dokumentationit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë: “SENKA”,sh.p.k + “GPG COMPANY”,sh.p.k në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në DST, Autoriteti Kontraktor, në pikën 2.2 *Kapaciteti ekonomik dhe financiar*, ka kërkuar: *”Kopje të çertifikuara të bilanceve për tre vitet e fundit kur ky informacion është i mundur”*, kriter i cili nuk përmbushet nga BOE, pasi bilancet e dorëzuara nga operatori ekonomik “SENKA”,sh.p.k, pjesë e BOE nuk janë të çertifikuara/konfirmuara nga organet Tatimore.

b) Autoriteti kontraktor, në pikën 2.3 *Kapaciteti teknik*, pika “9”, ka kërkuar: *Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë QKL III.2.B, Grumbullim, Transportim, Ruajtje e mbetjeve Urbane*. Komisioni i vlerësimit të ofertave referuar dokumentationit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë: “SENKA”,sh.p.k + “GPG COMPANY”,sh.p.k, ka konstatuar se nuk është paraqitur dokumentacion për përmbushjen e kriterit të mësipërm. Pra kriter i cili nuk përmbushet nga BOE.

c) Autoriteti kontraktor, në pikën 2.3 *Kapaciteti teknik*, pika “19”, ka kërkuar: *Operatori ekonomik duhet të paraqesë Analizë Çmimesh për të gjithë zërat e parashikuar në preventive*. Komisioni i vlerësimit të ofertave referuar dokumentationit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë: “SENKA”,sh.p.k + “GPG COMPANY”,sh.p.k, nuk kanë paraqitur dokumentacion për plotësimin e këtij kriteri. Pra kriter i cili nuk përmbushet nga BOE.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm për lidhjen e marrëveshjes kuadër:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë: “Ante-Group”.sh.p.k + “NOVA Construction 2012”,sh.p.k me NIPT: J62904100D + L22404012D
2. Operatori ekonomik: “GJIKURIA”,sh.p.k me NIPT J62903456H

Shënim: Referuar VKM-së Nr. 225 datë 12.04.2021 *“Për miratimin e dokumenteve standarte të procedurës së prokurimit, të kriterëve të vlerësimit të ofertës fituese kushteve të marrëveshjes kuadër dhe të kontratës për procesin e rindërtimit”*, kualifikimi i ofertuesve në fazën e parë, nuk është me pikë.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqiteni pranë: Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Sektori i Prokurimit, me adresë: Bulevardi “Bajram Curri”, Tiranë, brenda 3(tre) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 26.05.2021.

Ankesa: S’ka